



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

V E N D I M

**Nr. 73 , Datë 19 / 3 /2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 35, datë 21.06.2017, të paraqitur nga subjekti ankues A.G, kundër S.G, përfaqësuesve të Komisarariatit të Policisë Vorë dhe përfaqësuesve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “gjendjes ekonomike”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se ka telefonuar në Komisarariatit të Policisë Vorë dhe ka kërkuar ndihmë nga Policia (119, 122) për të verifikuar disa sende të marra nga banesa nga ish bashkëshorti i saj me të cilin është në proces divorci dhe ndarje pasurie. A.G shpjegon se ka kryer verifikimin e sendeve të munguara në banesë dhe më vonë është paraqitur në komisarariat për të bërë kallëzim. Përfaqësuesit e policisë së shtetit nuk i kanë kërkuar ish bashkëshortit që të rikthente mallin e përvetësuar me forcë dhe nuk i kanë dhënë asnjë lloj ndihme për shkak se ishte grua. A.G është ndjerë e diskriminuar, pasi nuk ka marrë asnjë ndihmë nga policia.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shqyrtimin e procesverbaleve të policisë Vorë për diskriminim për shkak të gjinisë.

Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacionet e dhëna prej ankuesit ishin të paqarta në lidhje me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr.644/1, datë 27.06.2017 ka kërkuar nga subjekti ankues dokumentacion dhe informacion plotësues.

Më shkresën datë 04.07.2017, subjekti ankues ka dërguar informacion dhe dokumentacion plotësues në lidhje me pretendimet e paraqitura.

Me shkresën nr.644/4, datë 02.08.2017, Komisioneri ka njoftuar subjektin ankues se nga shqyrtimi paraprak i ankesës, është konstatuar se: **Së pari**, pretendimet e paraqitura nga A.G

kundër S.G, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioneri, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 7, të LMD<sup>1</sup>, ky ligj siguron mbrojtje nga diskriminimi nga: “Çdo veprim ose mosveprim i **autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë<sup>2</sup> që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë<sup>3</sup> ose privatë<sup>4</sup>**, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”. Pra, S.G, në rastin konkret, sipas parashikimeve të bëra në LMD, nuk legjitimohet si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesë pranë KMD-së.

**Së dyti**, bazuar në formularin e ankesës nr. 35, datë 21.06.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij në datë 04.07.2017, Komisioneri vlerëson se, A.G është vënë në dijeni për veprimet dhe sjelljet diskriminuese nga ana e përfaqësuesve të Komisarariatit të Policisë Vorë, për denoncimet dhe kallëzimet e bëra që në datë 31.10.2015<sup>5</sup> dhe 15.04.2016<sup>6</sup>.

Gjithashtu, në lidhje me pretendimin për diskriminim të A.G nga ana e Bankës Kombëtare Tregtare për shkak të gjendjes ekonomike, pasi banka ka lejuar që me datë 03.01.2014, ish bashkëshorti i saj ..... të marrë me mashtrim vlerat monetare të përbashkëta të depozituara në këtë bankë, Komisioneri vlerëson se, A.G ka marrë dijeni për veprimet diskriminuese të bankës që në datë 31.10.2015 kur ka bërë dhe kallëzimin pranë Komisarariatit të Policisë nr.6, Tiranë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet ..... më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, këto pretendime të ankesës nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

**Së treti**, në lidhje me pretendimin për diskriminim nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri vlerëson se: Bazuar në deklaratimet e znj. Gërgeci si dhe në kopjet e dokumenteve<sup>7</sup> të sjellë si provë pranë Komisionerit nga subjekti ankues, rezulton se çështja për të cilën ankohet A.G, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu ky fakt vërtetohet dhe nga shkresa nr. 8735/1, datë 07.07.2017 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës

<sup>1</sup> Shkurtesë për “Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>2</sup> Sipas përcaktimeve të Kodit Civil, neni 24 citon: “*Personat juridikë janë publikë dhe privatë*”.

Neni 25 përcakton se: “**Personat juridikë publikë** janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen”.

Neni 26 përcakton se: “**Persona juridikë privatë** janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji”.

<sup>3</sup> **Sektori publik** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore.

<sup>4</sup> **Sektori privat** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

<sup>5</sup> Referuar procesverbalit të Komisarariatit të Policisë nr.6 Tiranë, datë 31.10.2015.

<sup>6</sup> Referuar procesverbalit të Komisarariatit të Policisë nr.6 Tiranë, datë 15.04.2016.

<sup>7</sup> Ankim, datë 12.06.2017 dhe datë 25.06.2017 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt kundër Vendimit datë 25.5.2017 dhe Vendimit datë 30.05.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

së Parë Tiranë, në të cilën informohet Komisioneri se A.G, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të Prokurorisë Tiranë.

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, në të cilën parashikohet: “.....Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata....”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me këto çështje, pasi këto pretendime janë bërë nga subjekti ankues, objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe është gjykata ajo që do të shprehet me vendim për këto pretendime.

Në lidhje me shkakun e pretenduar “gjendja ekonomike”, subjekti ankues nuk ka paraqitur informacion, fakte dhe prova për të provuar gjendjen ekonomike dhe lidhjen shkakësore për trajtimin e pabarabartë nga ana e subjekteve që pretendohet se kanë kryer veprimet diskriminuese. Si rezultat i kësaj, Komisioneri do shqyrtojë ankesën në lidhje me pretendimin vetëm për shkak të gjinisë kundër drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Vorë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën Nr.644/5, datë 02.08.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacioni subjektit, Komisaritati i Policisë Vorë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga A.G.

- Me shkresën nr.873, datë 11.09.2017 është njoftuar përsëri Komisioneri i Policisë Vorë në lidhje me ankesën dhe detyrimin për të kthyer përgjigje Komisionerit.

Me shkresat Nr. 1226/1, datë 19.09.2017 dhe nr. 1539/1, datë 03.10.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri i Policisë Vorë, në mes të tjerash informon se: *“Nga ana e Komisionerit janë ndjekur të gjitha rastet e denoncimeve të bëra nga shtetasja A.G dhe materialet i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e më konkretisht për rastin në fjalë ish bashkëshorti i saj është proceduar për veprën penale të vetëgjyqjesisë. Në çdo rast të parashtruar nga shtetasja A.G në lidhje me ankesat që ajo ka patur ndaj ish bashkëshortit, janë shqyrtuar me rigorozitet sipas ligjit”.*

Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve e cila nuk u realizua në datë 03.10.2017 për arsye të mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të Komisionerit të Policisë Vorë.

**Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:**

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Procedura për veprimet procedurale mbi marrjen e denoncimit dhe kryerjen e veprimeve të mëvonshme hetimore rregullohen sipas Ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i cili në nenin 283 pika 2, Kallëzimi nga ana e shtetasve, përcakton se: “Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit”. Ndërsa në nenin 284/2/3, Ankimi, përcaktohet se: 2. “Ankimi bëhet nga viktima te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale”, ndërsa në nenin 3 përcaktohet se: “Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij”.

Nga këqyrja e dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët, rezulton se në datë 06.05.2017, ora 13.00, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore, A.M është mbajtur procesverbali mbi kallëzimin e bërë nga ana e shtetasës A.G në të cilën mes të tjerash ka informuar dhe mbi veprimet e policisë të datës 07.04.2017 dhe datës 06.05.2017. Në vijim të veprimeve procedurale Komisioneri i

Policisë Vorë me shkresën nr.682/k, datë 11.05.2017 ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, materialet procedurale të kallëzimit të bërë nga shtetasja A.G ndaj bashkëshortit të saj.

Nga vlerësimi i dokumenteve të dorëzuara nga palët, rezulton se ankuesja, ka telefonuar<sup>8</sup> pranë shërbimit të Komisarariatit të Policisë Vorë dhe në të dy rastet shërbimi i policisë Vorë është paraqitur në vendin e ngjarjes dhe më vonë nga ana e strukturave të policisë është kryer marrja e kallëzimit nga ankuesja dhe është vazhduar me procedurat e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se veprimet e Komisarariatit të Policisë Vorë nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të trajtimit të ankesave të A.G për shkak të gjinisë.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

<sup>8</sup> Nw datat 07.04.2017 dhe 06.05.2017 ka telefonuar në numrin 129 dhe 112.

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases A.G, nga ana e Komisarariatit të Policisë Vorë, për shkak të gjinisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: gjinia)  
(fusha: te mira dhe sherbime)